

## ARKITEKTURA POPULLORE DHE ARKITEKTURA E KULTIVUAR

Terminologjia e fushës së veprave ndërtimore, është krahasimisht e vonë. Termi i përgjithshëm *arkitekturë*, apo arti i të ndërtuarit dhe i të zbukuruarit të ndërtesave të mëdha, i përket fillimit të shek. XVI, sipas fjalorit të mirënjohur *Larus*. Historia e arkitekturës, me fillesa rreth shek. XIX, ashtu si çdo fushë kërkimore, që prej nismave deri në kristalizimin e metodës hulumtuese, shfaq përcaktime, klasifikime dhe ndërlidhje të realitetit ndërtimor me atë ekonomiko-shoqëror.

Në kontekstin e këtij artikulli, me termin *arkitekturë* do të emërtojmë mbarë ndërtesat për banim dhe funksione të tjera, pavarësisht prej vlerave në rrafshin e veprimtarive të cilësuara artistike. Termi *arkitekturë popullore*, përfshin bashkësinë e ndërtesave të ideuara dhe të realizuara prej mjeshtërve, të cilët profesionin e kishin fituar në punë, përgjithësisht që në vogëlinë e tyre. Me termin *arkitekturë e kultivuar*, do të shfaqim veprat ndërtimore, të ideuara së pari prej profesionistësh të lindur në punë e sipër, por me arritje të spikatura dhe, si të tillë, të njohur që prej antikitetit deri në krijimin e shkollave të larta, të cilat përfshinin dhe fushën e arkitekturës. Më tej, prej këtyre shkollave, përherë në rritje profesionale dhe numerike, u formuan arkitektët e laureuar, të cilët e rritën krijimtarinë e emërtuar *arkitekturë e kultivuar*. Të dyja këto krijimtari arkitekturore kanë afri dhe dallime të përfillshme, kryesisht si pasqyrim i kërkesave ndaj ndërtesave, të cilat, përkatësisht bëjnë pjesë në grupet e arkitekturës popullore dhe asaj të kultivuar.

Në rrafshin kohor, arkitektura popullore, thuhet sinonim i banesës së shtresave të varfra dhe të mesme të shoqërisë, i ka fillesat më të hershme se arkitektura e kultivuar. Kjo e fundit, shfaqet me fillimin e diferencimit shoqëror të shoqërisë, sipas

nesh, arritjes së natyrshme e cila që zgjidhja, do të thoshim e vetme, për të mundësuar ecurinë krahasimisht të shpejtë të shoqërisë. Arkitektura popullore, në vendet europiane, me zhvillim më të shpejtë se ato të kontinenteve të tjerë, rreth kapërcyellit të shekujve XIX-XX, shfaq ulje, veçanërisht në qytete, ndërsa në vendet ballkanike dhe posaçërisht në hapësirat shqiptare, Pasluftës së Dytë Botërore, vërehet rënie e shpejtë e kësaj veprimtarie. Pra, besojmë se arkitektura popullore, në hapësirën europiane, shënon, thuajse fundin e saj, në shekullin e kaluar. Banesat kolektive, të llojit të bashkësisë së apartamenteve, sot thuajse të vetmet në qendrat qytetare, përherë dhe në rritje, janë vepra të arkitekturës së kultivuar. Nga sa u tha, kuptohet se arkitektura e kultivuar me fillesa më të vona se arkitektura popullore, do të mbijetojë me njerëzimin për arsye të kuptueshme, të cilat kanë në bazën e tyre profesionalizmin, antipod të improvizimeve. Më tej, prirjet njësuere të shoqërisë njerëzore, kanë bërë më të lehtë përhapjen e arritjeve cilësore ndërmjet të cilave dhe ato në fushën e gjerë të arkitekturës së kultivuar.

Sipas funksionit, bashkësia e gjerë e veprave ndërtimore mund të klasifikohet në katër njësi: ndërtimet mbrojtëse, ato të kultit, ndërtimet shoqërore-inxhinierike dhe banesat.

Bashkëmarrëdhëniet e këtyre njësive me projektuesit dhe ndërtuesit e tyre shfaqen të ndryshme, në hapësirë dhe në kohë, dhe shprehin prirjen për të kaluar prej diletantizmit në profesionalizëm. Me këtë duam të shprehim dukurinë e rënies, përherë e më qartas, të veprimtarive projektuese dhe zbatuese të veprave ndërtimore, prej projektuesve dhe zbatuesve joprofionistë në ata profesionistë, të dytët prej të cilëve, që rreth shek. XVIII, po dëshmojnë me diploma profesionin e fituar. Edhe në fushën ndërtimore, përparimi shfaqet me lindjen e profesionistëve të kultivuar, nëpërmjet institucioneve mësimdhënëse të shkallëve të ndryshme dhe më tej me ngushtimin e hapësirave të këtyre profesionistëve me nënndarje. Kështu zotërohen në thellësi dukuritë, duke iu afruar përherë dhe më tepër zgjidhjeve racionale.

Edhe në fushën ndërtimore, veçanërisht të asaj të banesës, vërehet dukuria, do të thoshim e natyrshme, e ndikimit të

drejtpërdrejtë të kushteve ekonomiko-shoqërore në tipologjinë dhe trajtimin tekniko-arkitekturor të këtyre veprave.

Shoqëria primitive, për arsytet e njohura ekonomike, të cilat shpreheshin qartazi në vështirësitë për sigurimin e mjeteve minimale të jetesës, duke mos mundësuar diferencim shoqëror, pasqyroheshin në njësinë e tipologjisë së banesave. Më tej, me rritjen e produktivitetit, filloi dhe diferencimi, i cili, mes të tjerash, shprehet edhe me llojet e ndryshme të banesave, prej atyre të masës së gjerë. Ky proces, përherë dhe në rritje, që në vetvete arritje e rëndësishme e përparimit shoqëror. Rruga natyrore e ecjes përpara të një pjese tepër të vogël të shoqërisë edhe në fushën e banesës, me kërkesa funksionale dhe estetike në rritje ndaj kësaj kategorie ndërtimore, që arritje e rëndësishme. Themi e rëndësishme, sepse ajo natyrshëm u bë shembull për t'u ndjekur dhe kështu vijimisht shoqëria eci shumë më shpejt përpara sesa të kishte ndjekur rrugën ideale të baraszvillimit. Kështu lindën pallatet princore, veprat e shquara të kultit, krahas figurave të shquara të arteve të mirëfillta, skulpturës, pikturës, muzikës së kultivuar etj. Thëksim i shfrytëzimit të shtresave të varfra, fakt i prekshëm, ishte pasojë sa e patjetërsueshme aq edhe e pamënjanueshme.

Vlerësimi i arkitekturës popullore, me sinonimet vendore, madje dhe minore, dukuri e shekullit XX dhe veçanërisht e gjysmës së dytë të tij, është një arritje e rëndësishme si në rrafshin e trashëgimisë ndërtimore, ashtu edhe të fushës kërkimore historike në përgjithësi. Me pohimin e mësipërm, do të kërkonim të theksonim të vërtetën e thjeshtë se historia është fusha kërkimore e gjurmimit të së kaluarës mbarënjëzore dhe aspak vetëm e ngjarjeve dhe figurave të cilësuar "të mëdha". Në vijim të saj, edhe historia e arkitekturës nuk duhet të jetë vetëm ajo e arritjeve "të shquara", por e mbarë veprimtarisë ndërtimore në shekuj. Fushat kërkimore historike, nëpërmjet përpjekjeve për njohjen e ngjarjeve të së kaluarës, duke arsyetuar sa më pranë botëkuptimeve të kohëve respektive, interpretojnë të dhënat e llojeve të ndryshme. Këto të dhëna, cilësohen me termin *dokument* dhe, si të tilla, janë baza mbi të cilën arrihen përfundime mbi pjesë të historisë të së kaluarës, duke i thëlluar ato me të dhëna

dhe interpretime më të reja dhe më të thelluara.

Krahas historisë së përgjithshme, çdo fushë e veprimtarisë njerëzore dhe madje e asaj natyrore, ka historinë e saj, si sinonim i parashtrimit të ecurisë në kohë të këtyre dukurive. Kuptueshëm, edhe veprimtaria arkitekturore mbarëshkullore ka historinë e saj. Në këtë fushë, në rolin e dokumentit të prekshëm janë rrënojat e ndërtimeve të vjetra, të ruajtura, të dala në dritë prej gërmimesh arkeologjike, apo ndërtime me lashtësi të ndryshme, të cilat ruhen ende.

Historitë e fushave të veçanta të veprimtarisë njerëzore, krahas të qenit dukuri në vetvete, janë njëherazi pjesë e historisë, në kuptimin parësor të termit. Mendojmë se studimet e derisotme të arkitekturës, duke pasur për objekt ndërtesat e realizimeve të spikatura, pra duke mënjanuar studimin e arkitekturës popullore, janë treguar larg rolit si pasqyruese të historisë mbarëndërtimore. Ne do të thoshim se trajtimi studimor i çdo fushe të veprimtarisë njerëzore, së pari duhet t'i kundrojë dukuritë e këtyre veprimtarive, nëpërmjet realizimeve të prekshme, të cilat marrin vlerat e dokumentit. Edhe termi *dokument*, etimologjikisht do të thotë ajo që shërben për të dhënë dijeni.

Besojmë se studimet e derisotme të historisë së arkitekturës, përgjithësisht, janë përqendruar në konsiderimin e kompozimit të jashtëm të ndërtesave dhe karakterit të dekorimit të tij, duke mos qëndruar ngushtas në rrethanat jetësore që kushtëzuan këto ndërtime. Ky qëndrim, do të thoshim, e pakëson ndjeshëm konsiderimin e veprimtarisë ndërtimore si dokument historik.

Mendojmë se kushtet ekonomiko-shoqërore, me kuptimin më të gjerë të këtij dyfjalëshi, janë shkakut parësor që ka kushtëzuar ngritjen e ndërtimeve në hapësirë dhe në kohë. Pikërisht në këtë kontekst, ashtu si kushtet ekonomiko-shoqërore pasqyrohen në karakterin e mbarë ndërtimeve në hapësirë dhe në kohë të caktuar, ashtu dhe e kundërta, pra kalimi prej dëshmive ndërtimore në realitetin që i krijoi, i vendos këto ndërtime, së pari, në rolin e dëshmisë dokumentare. Natyrisht, këto interpretime kërkojnë domosdo studime të gjera gjithëpërfshirëse të shembujve të mbetur, pjesërisht apo tërësisht,

mbi baza të shëndosha metodologjike, ende sot e kësaj dite. Këto baza mbështeten ndjeshëm mbi përfilljen e kësaj trashëgimie të paluajtshme ndërtimore, si burim historik i shkallës së lartë të vërtetësisë. Kuptohet se përjashtimi i kësaj trashëgimie, të themi artistikisht minore, nuk do të thotë se ajo duhet të qëndrojë larg konsiderimit, madje thelbësor, si dëshmi historiko-kulturore e kësaj trashëgimie, e cila numerikisht përfaqëson shumicën dërrmuese të bashkësive njerëzore mbarëbrezash.

Mendojmë se krahasimisht vonë, gjatë shekullit XX, u shfaq prekshëm interesimi për arkitekturën popullore. Padyshim, ky qe një hap i rëndësishëm për t'iu afruar ndjeshëm funksionit historiko-kulturor të mbarë trashëgimisë ndërtimore, së pari si vlerë dokumentare. Megjithëkëtë, po e pohojmë paraprakisht se edhe ky konsiderim pati ndikime të dukshme, do të thoshim negative, për përfilljen e ndërtimeve popullore me madhësi dhe vlera të veçanta. Edhe në këtë rast, sërish shfaqej mbyturazi koncepti pseudohistorik i kundërimit të së kaluarës, së pari dhe thujtse tërësisht, si vepër e sunduesve "të mëdhenj".

Duke konsideruar ndihmesat e mbarë shtresave shoqërore, siç përmendëm, me realizime qartazi të rëndësishme, si ato të shtresave tejet të pasura, praktikisht mospërfillja ndaj realizimeve prej shtresave të varfra, cenon rëndë realitetin historiko-shoqëror të së kaluarës. Me sa më sipër, donim të pohojmë se termi *shoqëri njerëzore* përmbledh mbarë shumësinë njerëzore, e cila prej barazisë në skamje, kalon shkallërisht në diferencime të theksuara pasurore për t'iu rikthyer prirjes për barazi në elementet thelbësore jetësore, si të banuarit, ushqyerit dhe veshjes. Nëse kemi parasysh biznesmenët e fuqishëm miliarderë, tepër të paktë, në thelb ata janë administratorët e këtyre fondeve dhe jo përdoruesit e tyre vetëm për qëllime vetjake dhe familjare.

Konsideratat e mësipërme, besojmë fort se nuk janë jashtë temës në trajtim, por hipoteza aspak gratuite, të cilat i shpreh një studiues me përvojë të pandërprerë 50-vjeçare në fushën e vlerësimit të banesës popullore shqiptare. Me termin e gjerë *vlerësim*, kuptojmë veprimtarinë gjurmuese për identifikimin e shembujve të arkitekturës popullore, dokumentimin, studimin, restaurimin dhe popullarizimin e këtyre vlerave të papërsëritshme

të trashëgimisë kulturore.

Arkitektura popullore në hapësirën e Shqipërisë politike, shfaqet me fillesa krahasimisht të hershme, të Pasluftës së Dytë Botërore. Dy shkaqe kryesore qëndrojnë në bazën e kësaj dukurie, për disa drejtime unike, në mbarë hapësirën europiane. Së pari, vjen në përfillje interesimi i bolshevizmit të skajshëm, apo enverizmit, i cili, duke pretenduar të ishte përfaqësuesi i interesave të popullit, shihte të kjo krijimtari lidhjen e drejtpërdrejtë të arkitekturës popullore në shtresat e varfra dhe të mesme të shoqërisë. Më tej, ruajtja e shembujve krahasimisht të shumtë të kësaj gjinie ndërtimore, për shkak të prapambetjes së vendit dhe njëherazi realizimeve të qëndrueshme teknikisht dhe kompozicionalisht të tyre, qenë parakushte për të nxitur nismën për vlerësimin e kësaj trashëgimie.

Është rasti për të përmendur edhe angazhimin sa profesional, aq edhe me mundësi realizimi të ideve të qarta të arkitektit Gani Strazimiri, gjallëruesit të vlerësimit të arkitekturës popullore shqiptare. Rasti shqiptar, në këtë fushë krahasimisht të re të trashëgimisë historiko-kulturore, në disa drejtime është sa i suksesshëm, aq edhe instruktiv. Kjo veprimtari u mbështet në parime e metodika të shëndosha, duke vlerësuar mbarë shfaqjet e arkitekturës popullore, pavarësisht prej shkallës së vlerave, gjithë duke konsideruar atë, pavarësisht prej kohës së ndërtimit dhe porositesit, duke përfshirë mbarë hapësirën e sotme shqiptare në fshat dhe në qytet. Më tej, vënia në mbrojtje e vlerave u shoqërua me veprimtaritë paralele studimore, garanci për mbijetesën e kësaj trashëgimie unike dhe të papërsëritshme.

Viti 1961 shënon një ngjarje madhore për trashëgiminë e arkitekturës popullore shqiptare me vënien në mbrojtje shtetërore të qyteteve-muze të Beratit dhe Gjirokastrës, si dhe të pazarit të vjetër të Krujës, me nismën e ark. G. Strazimitit. Është rasti për të vënë në dukje largpamësinë e tij, atëherë kur sensibilizimi për këto vlera në Shqipëri, madje edhe në vende të zhvilluara europiane, ishte thuajse i paqenë. Shpallja e Gjirokastrës dhe e Beratit "Pasuri Botërore", në vitin 2008, ishte një konfirmim autoritar i vlerësimit për këto qendra unike me rëndësi botërore, që në vitin krahasimisht të hershëm 1961.

Krijimi i Institutit të Monumenteve të Kulturës, në vitin 1965, i dha një shtysë të fortë veprimtarisë për vlerësimin e trashëgimisë së paluajtshme ndërtimore dhe posaçërisht arkitekturës popullore. Mbarë kjo veprimtari, kërkonte profesionistët e fushës, të cilët u vetëformuan në punë dhe nëpërmjet saj, pasi, në brezin e parë, u përzgjedhën prej G. Strazimit, mbi bazën e aftësive, duke përbërë një rast të rrallë, që prestigji politik të shfrytëzohej vijimisht për vepra pozitive.

Përgjithësisht, studiuesit dhe restauratorët e arkitekturës popullore janë formuar, duke qenë inxhinierë ndërtimi, apo arkitektë. Brezi i parë i këtyre veprimtarëve në fushën e arkitekturës popullore, për arsye të kuptueshme, u përfshi në mbarë veprimtaritë e përmbledhura në termin e përgjithshëm *vlerësim*. Kuptueshëm, së pari filloi veprimtaria e gjerë, njëherazi thelbësore, ajo e gjurmimit dhe e vënies në mbrojtje të veprave përfaqësuese të arkitekturës popullore shqiptare. Kjo veprimtari përfshin qytetin dhe fshatin, për të gjurmuar ndërtimet e ruajtura plotësisht, apo pjesërisht, natyrisht me ndryshime në kohë. Pa qenë njohur paraprakisht kriteret për vënie në mbrojtje të vlerave të rëndësishme të arkitekturës popullore, ato u ngjizën gjithë duke u formuar profesionalisht edhe personeli i ngarkuar edhe me këtë detyrë. Këto kritere, njëherazi janë: kriteri tipologjik, kriteri i autenticitetit, kriteri i vlerave arkitekturore, kriteri kohor, kriteri i shpërndarjes hapësinore të dukurisë arkitekturore, kriteri i ruajtjes paraprake dhe ai i bashkëjetesës së veprës arkitekturore me veprën e artit.

Kriteri tipologjik, është posaçërisht i rëndësishëm, sepse ndjekja e tij nëpërmjet shembujve përfaqësues, jep të dhëna të sakta mbi përhapjen e kësaj tipologjie në hapësirë dhe në kohë.

Kriteri i autenticitetit synon që të konsiderohen vlerat ndërtimore të arkitekturës popullore, të cilat janë origjinale, pra përgjithësisht të fazës së parë të ndërtimit, apo edhe faza të tjera të mëvonshme, të cilat nuk kanë tjetërsuar fazën parësore, por janë shtesa. Ky kriter e sheh monumentin në vërtetësinë e tij të pacenueshme, të parinovueshme, ashtu si çdo dokument të dhënë një herë dhe përgjithmonë, pra të patjetërsueshëm.

Kriteri i vlerave arkitekturore në kompozimin vëllimor dhe, më dukshëm, në trajtimin arkitekturor dhe dekorativ të elementeve të ndryshme, të pamjeve të jashtme dhe të brendësisë, gjithashtu është tregues për t'u përfillur, sepse ai shfaqet përcaktues në vepra paralele për nga kompozimi.

Kriteri kohor, lidhet me vlerësimin e kohës së ndërtimit të veprës, e cila, sa më e lashtë të jetë, aq më e vlefshme është, sepse shembujt e hershëm, përgjithësisht janë të rrallë. Shembujt e datuar kanë vlera të posaçme, sepse janë tregues të saktë të karakterit dhe llojit të përpunimit teknik e dekorativ në një kohë të caktuar dhe, si të tillë, bëhen tregues për datimin e përafërt të ndërtimeve, më së shumti të padatuara.

Është rasti për të theksuar se ndërtimet e fushës së arkitekturës popullore në këmbë, apo rrënoja, i përkasin më së hershmi shek. XVIII, prej të dhënave të sotme, ndërsa shumica e shembujve i përkasin shek. XIX, duke qenë gjysma e parë e tij, periudha me arritjet më të shënuara të arkitekturës tradicionale. Rreth mesit të shek. XIX, me ndryshimet e rëndësishme të mënyrës së jetesës, drejt koncepteve kapitaliste që karakterizohen prej rritjes së njërive ndërtuese dhe përgjithësisht prodhuese, nxitur prej shumimit dhe zgjerimit të kërkesave jetësore prej qytetarëve, tipologjia e banesës qytetare pëson ndryshime thelbësore drejt njësimi, duke u shfaqur një tip i ri banese qytetare.

Kriteri i përhapjes hapësinore të tipologjisë lidhet me lënien e gjurmëve të dukshme të përhapjes rajonale të tipologjisë, duke vënë në mbrojtje vepra të së njëjtës tipologji në mbarë vendin.

Kriteri i ruajtjes paraprake lidhet me nevojën e hapësirave kohore për vendimmarrjet e duhura profesionalisht dhe administrativisht. Së fundi, kriteri i bashkëjetesës së veprës arkitekturore me të artit rrit vlerat e shembujve që bartin veprat e arkitekturës popullore dhe, si të tilla, rrisin gjasat për ruajtjen e tyre. Më prektas, termi i përgjithshëm *ruajtje*, në rastin e veprave ndërtimore, pra dhe shembujve të arkitekturës popullore, do të thotë, vënie në mbrojtje shtetërore të veprës, apo ansambleve ndërtimore, deri te qendrat historike, në cilësinë e monumenteve të kulturës.

Vënia në mbrojtje e monumenteve të kategorisë së arkitekturës popullore lidhet me dokumentimin e tyre të gjerë grafik, fotografik dhe përshkrimor, të cilët pasqyrojnë gjendjen e veprës, apo të ansamblit në cakun kohor kur ai është vënë në mbrojtje. Ky dokumentacion pasurohet vijimisht me thellime, njëkohësisht dhe me pasqyrime të cilat paraqesin gjendjet në ndryshime të natyrshme të veprës, rrënimet eventuale prej shkaqesh të ndryshme, si dhe me gjendjet pjesërisht të reja që sjellin ndërhyrjet restauruese. Pohimi se arkitektura popullore, ashtu si mbarë trashëgimia kulturore në përgjithësi, është së pari dokument historik, shfaq dëshmitë potenciale që përmbajnë këto vepra, të cilat duhen njohur dhe, më e rëndësishmja, duhen interpretuar. Njohja dhe interpretimi janë thelbi i asaj veprimtarie të pambarim që synon të thellojë dhe të zgjerojë të vërtetat që rrjedhin prej monumentit dhe emërtohen *studim*. Monumentet, të pashoqëruar me veprimtarinë paralele *studim*, e cila zbulon kuptimin e tyre si dëshmi historiko-kulturore, do të ishin thjeshtë relike interpretimesh profane, pra vlera të pavlerësuara në domethënien e tyre madhore.

Krahas studimit, mirëmbajtja e përhershme e monumentit dhe restaurimi shfaqin një dukuri që bashkëshoqëron monumentin në kohë dhe shkallë të ndryshme ndërhyrjesh. Monumenti, në rastin në shqyrtim, bashkëpërbërës i gjinisë së arkitekturës popullore, përgjithësisht ngritur me teknika të brishta dhe shfrytëzim tejet të dendur, pëson vetërenie materialo-teknike, deri në vetëshkatërrim, nëse mungojnë ndërhyrjet e duhura. Kur flasim për ndërhyrjet, krahasimisht të gjera, të emërtuara *restaurim*, ato do të cilësoheshin si synuese të ruajtjes së gjendjes dhe të përbërësve origjinalë, thelbi i vlerave autentike të veprës, në rastin tonë të monumentit. Parimet e restaurimit të monumenteve dhe të ansambleve monumentale, tashmë janë të kodifikuara nga pikëpamja metodike. Edhe në realitetin shqiptar, këto parime janë përvetësuar, duke iu përshtatur rrethanave tona shoqërore dhe kulturore, pa cenuar thelbin e tyre ndërkombëtar. Ky thelb, i cilësuar ndërkombëtar, mbështetet në parimin përherë dhe në zgjerim se mbarë krijimtaritë, krahas së qeni pasuri kombëtare, janë njëherazi edhe pasuri e mbarë njerëzimit.

Praktika, krahasimisht e re, e përzgjedhjes së veprave më të shquara të shoqërisë njerëzore, për t'u mbrojtur në cilësinë "Pasuri Botërore", është tregues i përfillshëm. Rasti i krijimtarisë shqiptare, e cila përfaqësohet me tri qendra historike, ndër të cilat dy i përkasin arkitekturës popullore shqiptare, është vetiu domethënës.

Në Shqipërinë e Pasluftës së Dytë Botërore, natyrshëm, vënia në mbrojtje e veprave ndërtimore me domethënie historiko-kulturore, u shoqërua me veprimtarinë e restaurimit të këtyre vlerave unike. Për arsyet e njohura, të cilat lidhen kryesisht me shfrytëzimin e dendur të banesës popullore, si dhe ndryshimit të kërkesave jetësore ndaj saj, restaurimi i këtyre vlerave paraqet veçanti, pa cenuar parimet e njohura të restaurimit. Këto parime u përkasin arkitekturës popullore dhe asaj të kultivuar. Shkurtas, këto parime synojnë, së pari, ruajtjen e vlerave autentike të monumentit në rrafshin kompozicional, teknik, të zburimores dhe llojit të materialeve. Ndërhyrjet restauruese nuk do të thonë aspak se synohet rikthim i veprës në gjendjen origjinale. Monumentet vijnë përgjithësisht me faza të ndryshme ndërtimi, në momentin e vënies në mbrojtje. Të gjitha këto faza kanë vlera për historikun e veprës dhe, si të tilla, ruhen, me përjashtim të rasteve të veçanta. Ndërhyrjet mirëmbajtëse dhe ato pjesërisht rindërtuese të strukturave të paqëndrueshme, si zgjidhja e vetme dhe kuptueshme e rrallë, duhet të kryen sipas teknikave dhe materialeve origjinale. Thelbi i ndërhyrjeve restauruese është mirëmbajtja e vazhdueshme e veprave të arkitekturës popullore, e cila parandalon zgjerimin e dëmtimeve deri në shkatërrime të pjesshme, pra humbje pjesore të autenticitetit të ndërtimit.

Studimi dhe restaurimi i arkitekturës popullore janë dy disiplina bashkëplotësuese. Restauratori detyrimisht duhet të jetë edhe studiues i fushës, në të cilën përfshihet monumenti që do të restaurohet prej tij, duke u paraprirë me projektin e restaurimit dhe ndjekjen e ndërhyrjeve restauruese. Rasti shqiptar i vlerësimit të arkitekturës popullore shfaqet me vetëformim të shpejtë dhe me një angazhim profesional përherë dhe në rritje.

E rëndësishme është të theksojmë se në sajë të centralizimit profesional dhe të angazhimeve të konsiderueshme financiare, gjurmimi, vënia në mbrojtje dhe restaurimi i arkitekturës popullore në Shqipëri ka shënuar arritje, do të pohojmë shembullorë. Botimet, lidhur me temën e gjerë, vlerësimi i arkitekturës popullore shqiptare, me fillesa rreth viteve shtatëdhjetë të shekullit të kaluar, janë me rritje të dukshme numerike dhe profesionale. Së pari, artikujt në revista kërkimore dhe posaçërisht në atë "Monumentet", dhe më pas, albumet dhe monografitë janë ndihmesa të mirëfillta në fushën më të re të shkencave albanologjike, atë të arkitekturës popullore. Gjatë dhjetëvjeçarit të parë të shekullit tonë vërehen nismat me synime përgjithësuese mbi bazën e studimeve mbi rrafshet tipologjike, kryesisht në qytete, dhe krahinore në fshatra. Arritje e rëndësishme duhet mbajtur përpjekja për parashtrimin e metodikës së vlerësimit të arkitekturës popullore, e cila, pa pretenduar zgjidhje përfundimtare, merr vlera të rëndësishme parësore. Vlerësimi i arkitekturës popullore, duke qenë veprimtari e përhershme në kërkim të të vërtetave, nëse udhëhiqet prej kriteresh metodike, kryesisht mbështetur në përvojën kërkimore, përfundimet do të jenë më të shpejta dhe më pranë realiteteve që i krijuan. Natyrisht, edhe metoda kërkimore në këtë fushë është në ecuri të pandalshme. Në rrafshet europian dhe më gjerë, arkitektura popullore shqiptare dhe gjinia e ndërtimeve mbrojtëse zënë një vend të shquar. Vepër e etnosit iliro-arbëresho-shqiptar, autokton që prej muzgut të historisë në trojet e veta, këto ndërtime janë dëshmi e vitalitetit dhe E zhvillimit të kësaj bashkësie qartësisht të dallueshme në rrjedhë të kohës.

## Bibliografia

1. A. Baçe, A. Meksi, E. Riza, Gj. Karaiskaj, P. Thomo, Historia e arkitekturës shqiptare, Tiranë, 1979.
2. A. Baçe, A. Meksi, E. Riza, Berati, historia dhe arkitektura, Tiranë, 1988.
3. A. Meksi, E. Riza, Ndërtimet në fshatin rrënojë të Kamenicës, "Monumentet", 7-8/1974.
4. A. Muka, Aspekte metodologjike të studimit të banesës